

PJESËMARRJA QYTETARE NË VENDIM-MARRJE

Pjesëmarrja qytetare nënkupton një veprim individual ose kolektiv, me qëllim identifikimin dhe adresimin e çështjeve me interes publik. Pjesëmarrja qytetare është një proces ku qytetarët organizojnë vetën dhe qëllimet e tyre në nivelin praktik dhe punojnë së bashku qoftë në nivel individual ose përmes organizatave të shoqërisë civile për të ndikuar në procesin e vendimmarrjes. Pjesëmarrja në procese vendim-marrëse do të thotë mundësi për qytetarët, OShC-të dhe palët e tjera të interesuara për të ndikuar në zhvillimin e politikave dhe ligjeve të cilat i prekin ata. Pjesëmarrja qytetare nuk i pezullon kompetencat kushtetuese dhe ligjore të përfaqësuesve të pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ në procedurën e miratimit dhe zbatimit të ligjeve, si dhe të instrumenteve të politikave publike, por për më tepër ua mundëson autoriteteve t'i zbatojnë këto kompetenca në mënyrë më efikase.

CILAT JANË NIVELET KRYESORE TË PJESËMARRJES QYTETARE?

Ekzistojnë katër nivele të ndryshme të pjesëmarrjes, duke filluar nga ai me pjesëmarrje më të ulët deri te niveli me pjesëmarrje më të lartë: informimi, konsultimi, dialogu dhe partneriteti. Qasja në informatë është baza e çdo hapi të ardhshëm të pjesëmarrjes. Ky nivel relativisht i ulët i pjesëmarrjes ka të bëjë me dhënien e informatës një-drejtimëshe nga autoritet publike dhe përfshirja e organizatave të shoqërisë civile as nuk është e kërkuar e as e pritur. Konsultimi është

formë e iniciativës ku autoritetet publike u kërkojnë organizatave të shoqërisë civile mendimin e tyre në një fushë specifike të politikave ose të zhvillimit, ose dokument të caktuar zyrtar, ndërsa pritet reagimi/kontributi i OShC-ve ndaj kësaj ftese. Konsultimi mund të jetë i fokusuar në një grup të caktuar apo në publikun e gjërë, ndërsa gjithmonë duhet të ndërmerret aq herët sa ende të ketë mundësi ndikimi nga ata që kontribuojnë. Konsultimet e gjera me shkrim dhe takimet publike janë format më të përdorura të konsultimit ndërsa forma tjera përfshijnë konferencat, takimet me Grupe të Fokusit/Interesit, punëtoritë, intervistat/takimet sy-në-sy, hulumtimet e opinionit, etj. Dialogu mund të jetë i gjerë apo specifik. Dialogu i gjerë nuk është i lidhur me ndonjë proces specifik të zhvillimit të politikave, por mbetet i përgjithshëm dhe kryesisht synon përcaktimin e agjendës. Dialogu specifik ndërtohet në interesa të përbashkëta për zhvillim të një politike të caktuar, ndërsa rezulton me rekomandime dhe veprime konkrete. Partneriteti parasheh përgjegjësi të përbashkëta gjatë çdo hapi

CILI ËSHTË ROLI I ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË PJESËMARRJEN QYTETARE?

Si nivel më i lartë i organizimit qytetar, organizatat e shoqërisë civile luajnë rol qendror në pjesëmarrjen qytetare. OShC-të luajnë rol të shumëfishtë në këtë proces: ato janë një mjet që u mundësojnë qytetarëve të organizohen dhe të shprehin interesat e tyre legjitime në mënyrë më të efektshme, por në të njëjtën kohë janë edhe palë të këtij procesi. Legjitimiteti dhe fuqia e shtuar në raport me veprimin individual, resurset më të mëdha dhe qasja sistematike i bëjnë OShC-të aktorë shumë të rëndësishëm të pjesëmarrjes qytetare. Përveç që shërbejnë si mjet dhe palë, OShC-të gjithashtu synojnë të mbikëqyrin nëse parimet dhe mekanizmat e pjesëmarrjes janë duke u zbatuar si duhet.

të procesit politik të vendim-marrjes, duke filluar nga caktimi i agjendës, draftimi, vendimi dhe zbatimi i iniciativës politike apo ligjit të caktuar. Përveç tjerash, në partneritet OShC-të janë palë të barabarta në gjithë ciklin e politikë-bërjes, përfshirë edhe kompetenca në zbatim të pjesëve specifike të politikës përkatëse.

CILAT JANË ELEMENTET KRYESORE TË ZBATUESHME NË KOSOVË?

Në parim, të gjitha nivelet e pjesëmarrjes qytetare zbatohen edhe në Kosovë. Megjithatë, ndërveprimi kryesor në mes të qytetarëve dhe autoriteteve publike mbetet në nivelet e informimit dhe konsultimit publik. Bazuar në Kushtetutën dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë, secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë. Kjo nënkupton që qytetarët duhet të informohen rreth caktimit të agjendës, draftimit të rregulloreve, ligjeve dhe politikave, mënyrës dhe aktit të vendim-marrjes, mënyrës dhe nivelit të zbatimit të politikave, mënyrës dhe rezultateve të mbikëqyrjes dhe procesit të riformulimit të politikave. Në praktikë, mjetet dhe mekanizmat që sigurojnë informim të duhur të qytetarëve dhe

OShC-ve janë të kufizuara dhe ofrojnë kryesisht informata statike dhe informata rreth ligjeve të miratuara apo procedurave bazike administrative. Konsultimi publik është obligim ligjor që vlen për të trija nivelet e pushtetit: nivelin lokal, qeveritar dhe Kuvendin e Kosovës. Komuna duhet t'i njoftojë qytetarët mbi 'planet ose programet e rëndësishme për interesin publik'. Qytetarët e një komune kanë të drejtë për të marrë pjesë në aktivitetet e komunës përkatëse, të drejtën e peticionit, iniciativës qytetare, referendumit lokal ndërsa komunat obligohen që të themelojnë komitete konsultative brenda sektorëve, në të cilat duhet të ftohen edhe përfaqësues të OShC-ve. Të gjitha aktet qeveritare (përveç vendimeve me karakter administrativ) duhet që paraprakisht të konsultohen me publikun, ndërsa qeveria obligohet që të ofrojë informata të mjaftueshme rreth dokumentit që konsultohet, kohë të mjaftueshme për kontribut si dhe të raportojë për rezultatet e konsultimit. Për të gjitha ligjet që aprovohen nga Kuvendi i Kosovës mund të organizohen dëgjime publike, ndërsa OShC-të mund të marrin pjesë edhe në takimet e komisioneve parlamentare. Në praktikë, edhe konsultimi publik është i kufizuar qoftë në lloje apo numra të dokumenteve që konsultohen me publikun, ashtu edhe me mjetet dhe mënyrat që shfrytëzohen për të mbledhur kontributin e të gjitha palëve të interesuara. Dialogu dhe partneriteti ekzistojnë në raste specifike dhe jo shumë të shpeshta. Gjithashtu, mënyrë specifike e pjesëmarrjes qytetare është mundësia për të propozuar ligje drejtëpërdrejt në Kuvendin e Kosovës, nëpërmjet nënshkrimit të nismës legjislative nga 10,000 qytetarë. Dokumentet kryesore me të cilat rregullohen elementet e sipërpërmendura janë: Kushtetuta, Ligji për Qasje në Dokumente Publike, Ligji për Vetqeverisje Lokale, Rregullorja e Punës e Qeverisë, Rregullorja e Punës e Kuvendit, Ligji për Nisma Legjislative, etj.

CILAT JANË PARAKUSHTET KRYESORE TË PJESËMARRJES QYTETARE?

Disa nga parakushtet kryesore të pjesëmarrjes qytetare janë: **parametrat/rregullat e pajtuara paraprakisht** nga të dyja palët, **besimi i ndërsjellë** që të dyja palët angazhohen për përmirësimin e jetës së qytetarëve, **llogaridhënia dhe transparencja** e dyanshme për mënyrën dhe rezultatet e pjesëmarrjes, si dhe e drejta e OShC-ve për **veprim të pavarur** dhe avokim për pozicione të ndryshme nga ato të autoriteteve, me të cilat përndryshe mund të bashkëpunojnë.

CILAT JANË INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR ZBATIM?

Në parim, të gjitha njësitet e autoriteteve publike që janë përgjegjëse për hartim dhe zbatim të politikave janë përgjegjëse për sigurimin e pjesëmarrjes qytetare. Megjithatë, disa nga institucionet/njësitet më të rëndësishme që janë përgjegjëse për të përfshirë qytetarët në punën e autoriteteve publike janë: Kryetarët e Komunave, Zyret për Informim në Komuna, Zyret për Informim në Qeveri dhe Ministri, Zyra për Qeverisje të Mirë pranë ZKM-së, Zyra Ligjore pranë ZKM-së, Zyra për Informim e Kuvendit të Kosovës, etj.

Duke njohur faktin që jo vetëm organizatat jo-qeveritare të regjistruara (OJQ-të) bëjnë pjesë në shoqëri civile, termi OShC u referohet të gjitha formave të organizuara të shoqërisë civile. Termi OJQ, në këtë dokument, përdoret vetëm në rastet kur flijet për dispozitat konkrete ligjore të cilat u referohen konkretisht organizatave jo-qeveritare të regjistruara (OJQ-ve).

ORARI I PUNËS
 e hënë – e premte
 10:00 deri 14:00



Qendra ofron si dhe i përgjigjet çdo kërkesë për informacion për nevojat e organizatave të shoqërisë civile (OShC), qytetarëve të interesuar, institucioneve publike dhe organizatave donatore për zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë.

QËLLIMI I QENDRËS:

- Ngritja e kuptimit mbi rolin e shoqërisë civile në demokratizimin e vendit
- Ngritja e kuptimit mbi rolin e shoqërisë civile në procesin e politikë-bërjes dhe vendim-marrjes
- Grumbullimi dhe shpërndarja e informacionit rreth sektorit të shoqërisë civile
- Krijimi i instrumenteve për mbledhjen dhe analizën e vazhdueshme të të dhënave për sektorin e shoqërisë civile dhe fusha të veçanta të këtij sektori
- Ngritja e kapaciteve të OShC-ve dhe institucioneve publike për bashkëpunimin ndërsektorial
- Promovimi dhe përkrahja e drejtpërdrejtë në qeverisjen e mirë të brendshme të OShC-ve

ÇKA OFRON QENDRA?

- **Deskun e informacionit** i cili i përgjigjet çdo kërkesë për informacion rreth sektorit të shoqërisë civile dhe pranon kërkesat e OShC-ve për trajnime, përkrahje dhe mentorim
- **Trajnime bazike dhe të avancuara** për pjesëtarët e OShC-ve, në baza të rregullta ose në bazë paraqitjes së kërkesës nga ana e OShC-ve
- **Shërbimin e këshillimit gjatë punës dhe mentorimit** që ofron këshillim dhe mentorim në punën e përditshme të OShC-ve në bazë të kërkesës së tyre
- **Këndin e informacionit** ku vizitorët mund të marrin informata rreth sektorit të shoqërisë civile dhe broshura e artikuj informues për këtë sektor
- **Këndin e leximit** që mund të presë deri në 10 vizitorë
- **Këndin e bibliotekës** ku vizitorët mund të gjejnë libra dhe artikuj nga fusha e zhvillimit të shoqërisë civile dhe procesit të integritimit evropian
- **Sallën** e pajisur me të gjitha elementet me kapacitet deri në 25 persona

CILAT JANË RREGULLAT PËR VIZITORË?

Broshurat dhe fletushkat jepen falas për të gjithë vizitorët

Librat, buletinët dhe publikimet tjera mund të lexohen vetëm brenda Qendrës

Të gjithë të interesuarit për shërbimet e Qendrës duhet të kontaktojnë deskun e informacionit, me shkrim apo drejtpërdrejtë